

VENDIM
Nr.776, datë 11.10.2006

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.119, DATË 18.3.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PROCEDURAT E PRIVATIZIMIT, ME ANKAND, TË PAKETAVE SHTETËRORE TË AKSIONEVE TË SHOQËRIVE TREGTARE, QË VEPROJNË NË SEKTORËT JOSTRATEGJIKË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.8334, datë 23.4.1998 “Për privatizimin e shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.119, datë 18.3.2000 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në kapitullin I shkronja “D” “Formula e privatizimit”, pika 3 të riformulohet, si më poshtë vijon:

“3. Në përcaktimin e paketës së aksioneve shtetërore, që i ofrohet blerësit, aksionari shtet kërkon mendimin e organit të varësisë administrative.”.

2. Në kapitullin II shkronja “A” “Paketa e aksioneve, që i ofrohet me ankand blerësit të vetëm”, pas pikës 14 shtohet pika 15 me këtë përmbajtje:

“15. Në rast se në ankandin për shitjen e paketës së aksioneve shtetërore, që i ofrohet blerësit të vetëm, ka vetëm 1 kërkesë, e cila regjistrohet, por nuk shpallet fituese e ankandit, atëherë bëhet edhe një botim tjetër për një periudhë 10-ditore. Pas këtij afati, në rast se ka kërkesa të tjera për blerjen e kësaj pakete, ato konkurrojnë me kërkesën e parë, të regjistruar para 10 ditëve, në të kundërt kërkesa e vetme shpallet fituese e ankandit.”.

3. Në kapitullin II shkronja “C” “Privatizimi i paketës së aksioneve shtetërore në shoqëri, pjesërisht të privatizuara”, në fund të pikës 8, shtohen paragrafët, me këtë përmbajtje:

“Për caktimin e ekspertëve dhe miratimin e raportit të tyre të zbatohen dispozitat e legjisllacionit tregtar në fuqi.

Në rast se kjo procedurë nuk realizohet, atëherë aksionari shtet vlerëson shoqërinë, sipas tregut aktual, për efekt të shitjes së aksioneve të veta, duke emëruar ekspertë të pavarur, të cilët do të paguhën nga fondet buxhetore të miratuara për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në programin “Mbështetje për zhvillim ekonomik”.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha